

## Kosova me Vivianit

### Vivianiti e radhitë minieren e Stantregut ne vendet e rralla te pasurive kristalore



Vivianiti ky mineral me bukuri te rralla ndodhet ne minieren Stantërgut.

Ky mineral i cili e mban emrin J.G.Vivian , mineralogut britanez i cili e gjeti këtë mineral në Cornwall.

E ka epitetin e gurit të çmuar dhe gjendet shumë rrallë. Fortësia e tijë sipas shkalles së Mosit është 1.5-2. Pesha vëllimore 2.6-2.7 ( $\text{g}/\text{cm}^3$ ).

I pa ngjyrë në zonat oksiduese prej ngjyrës se gjelbër gjerë ne atë te kaltër. Kristalizon në sistemin monoklinik.

Ky kristal i rrallë është dhunti e kushteve gjeologjiko-mineralogjike të minierës së Stantërgut.

Andaj për shkak të bukurive të rralla si dhe për shkak se ai mund te gjendet shumë vështirë mineralogët, kristalografet, grumbulluesit e mineraleve të rralla si dhe hobistet e bukurive të rralla natyrore e kërkojne atë me të madhe. Për tu krijuar ky mineral duhet në ate mes te ketë siderite, limonite, karbonate dhe fosfate. Këto rrethana i ke ne pjeset e epërme të minierës së Stantërgut dikund gjer në 150 m. thellësi që i pergjigjet horizontetit të parë të kësaj miniere.